



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Njoftim për aplikim

2018-05-22 08:18:00

NJOFTIM PËR PËRZGJEDHJEN E NJË KOMPANIE AUDIO-VIDEO

Në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II Shqipëri-Kosovë 2014-2020, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si koordinatori Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial, fton të interesuarit për të shprehur interes për shpalljen në vijim:

Prodhimin e një dokumentari për projektet më të mira të Programit IPA CBC Shqipëri – Kosovë.

Në kuadër të programit të mësipërm, MEPJ shpall njoftimin për seleksionimin e një kompanie Audio/Video për krijimin dhe prodhimin e një dokumentari të Programit IPA CBC Shqipëri-Kosovë.

Kërkesat dhe kualifikimet e personit përfaqësues të Kompanisë:

- Diplomë universitare dhe/ose trajnime për gazetari/prodhim filmi/prodhim dokumentari;
- Rrjedhshmëri në gjuhën e shkruar dhe të folur angleze dhe gjuhën shqipe;

Eksperiencia profesionale specifike e Kompanisë/personit përfaqësues:

- Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë profesionale të mëparshme në prodhimin e dokumentareve apo filmave me metrazh të shkurtër apo të gjatë.
- Do të jetë një avantazh, eksperiencia në krijimin e të paktën 2 dokumentarëve kombëtare ose rajonale.

Procedura e aplikimit

Kompanitë/peronat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e aplikimit si më poshtë:

- Letër motivimi në anglisht (ku të cilësohen dhe ofertat financiare, kapacitetet e studios së prodhimit si edhe eksperiencat e mëparshme)
- Curriculum vitae (CV) e kandidatit në formatin Europass në anglisht;
- CV e Kompanisë në anglisht;
- Fotokopje të diplomës/ave universitare të kandidatit dhe/ose trajnimeve specifike;
- Dokumente të tjera mbështetëse mbi eksperiencën e mëparshme (letra reference, certifikata, etj.).

Termet e referencës janë të disponueshme [bashkëlidhur](#) këtij njoftimi.

Të interesuarit duhet ti dorëzojnë dokumentet e aplikimit deri me datë **18.05.2018**, ora 14.00, në adresën si në vijim:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Drejtoria e Fondeve të BE-së, Bulevardi Gjergj Fishta, Tiranë, Shqipëri. Objekti: "Aplikim

për Prodhimin e një dokumentari për projektet më të mira të Programit IPA CBC Shqipëri – Kosovë”

Vetëm Kompanitë/personat e përzgjedhur paraprakisht (short-listed), do të kontaktohen.